

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.14833/12, datë 19.11.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 20.12.2012 merr

## AKTVENDIM

**REFUZOHET** ankesa e paraqitur si e **PABAZUAR**.  
**VËRTETOHET** aktvendimi i atakuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.  
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIONJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dip. Dep.	DPK/DMP
Nr. Prot. Bë Prot. Prot. No.	03-76/2013
Date Datum Dat.	18-01-2013
PRISHTINE	

## Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr.regj.14833/12, datë 19.11.2012, e ka pezulluar procedurën kundërvajtëse ndaj Valbona Petrovcit nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen e Kontrollit të Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar, konform nenit 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se nuk ka prova se e pandehura ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë.

Kundër këtij aktvendimi Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka paraqitur ankesë për shkak të:

-vendimit mbi dënimin.

Në arsyetim të ankesë përpos tjerash thekson se gjykata e shkallës së parë e pezullon procedurën kundërvajtëse kundër zyrtarit të lartpërmendur edhe pse ekzistojnë të gjitha faktet dhe rrethanat në të cilat e pandehura ka kryer veprimin kundërvajtës për mosdeklarim të pasurisë. Më tutje thekson se e pandehura nuk e ka deklaruar pasurinë përkundër faktit se zyrtari kontaktues e ka njoftuar të pandehurën për një obligim të tillë, se kjo kundërvajtje përkon me një përgjegjësi të lartë publike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në pajtim me ligjin nr.04/L-050 përkundër faktit se Agjencia kundër Korrupsionit i ka bashkangjitur provat me të cilat vërteton kundërvajtjen e kryer nga zyrtari publik. Andaj propozon që aktvendimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarimin e të pandehurës të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 11.10.2012 në të cilin thekson se nuk është njoftuar nga pika kontaktuese për obligimin e saj, si dhe nga dëshmia e dëshmitarëve: Besim Pllana të dhënë më datë 11.10.2012, Shefki Krasniqi të dhënë më datë 15.10.2012 si dhe përfaqësuesi i antikorrupsionit Agron Behrami të dhënë më datë 03.12.2012, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, padyshim është vërtetuar gjendja faktike se e pandehura nuk është njoftuar për obligimin e saj për deklarimin e pasurisë nga ana e zyrtarit kontaktues siç parashihet në nenin 4 2.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen,

03-76/2013/02  
sluj

2.

dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave nr.04/L-050, për çka me të drejtë është pezulluar procedura kundërvajtës në vështrim të nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, kurse thëniet ankimore të ushtruesit të kërkesës se zyrtari kontaktues e ka njoftuar të pandehurën brenda afatit ligjor për deklarimin e pasurisë nuk janë mbështetur me asnjë provë, andaj ankesa e parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsionit është konsideruar e pabazuar, ndërkaq aktvendimi i atakuar vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga sa u tha më lartë në vështrim të nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

**GJL.nr.1436/2012 të datës 20.12.2012.**

**SEK. JURIDIKE,**  
**Zymrije Çunaku**



**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Dalip Bega**